

Proshet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË ASETVE DHE KADASTRËS
SEKTORI I KADASTRËS DHE RREGJISTRIMIT TË ASETVE

Nr. 17130 Prot.

Lezhë, më 23.10 2024

NJOFTIM

"PËR ORGANIZIMIN E DËGJESËS PUBLIKE NË LIDHJE ME MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE QË KËRKOHEM TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHE, PËR PASURITË ME NR. 24/10, NR. 49/12 NË ZK 1987,NJ.AD. SHËNGJIN".

Bashkia Lezhë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9 pika 1.2 germa a, të ligjit numër 8743 datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit" neni 8 i ndryshuar, Ligji 8744 date 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 2, Neni 4, Neni 6, Neni 7, Neni 8, Neni 9, Neni 11, Neni 12, Ligji 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në republikën e shqipërisë" neni 36, neni 37, pika 3 e neni 39, Seksioni IV, Ligji 111/2018 "Për Kadastrën" Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, Vendim nr.28 datë 27.01.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listës së pronave shtetërore dhe rregullave për bashkpunim ndërmjet institucioneve", Ligjit 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", neni 24, Udhëzimin nr 30 dt 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar), Udhëzimin nr 15 dt 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", të VKM nr 500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore" si dhe në Udhëzimin nr. 3 datë 18.07.2002 të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit "Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore",

Në vijim të procesit të konsultimit me publikun, ju ftojmë të merrni pjesë në dëgjesën publike, ditën e **mërkurrë**, në datën, **13.11.2024**, në orën **11.00**, në sallën e **Bibliotekës "Gjergj Fishta" Lezhë**, ku do të bëhet prezantimi i avantazhit dhe shfrytëzimit të këtyre pronave në të mirën e komunitetit, ku një ndër nevojat urgjente është për zhvillim ekonomik të qytetit Lezhë.

Ju mirëpresim për të ndarë mendimet tuaja!

KRYETARI
Pjerin NDREU

